Numër: 01/230
Datë: 29.04.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "JCODERS" SH.P.K me qendrat në adresën: Rr. Rifat Burdzeviç, Prishtinë, dhe degët: Rr. Lekë Matranga, Prizren, Rr. Elena Gjika, Pejë, Rr. Mbretëresha Teuta, Mitrovicë, dhe Rr. Sadullah Brestovci, Gjilan, Rr. Elena Gjika, Pejë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 29.04.2022 deri 28.04.2025, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   - **1.1 JUNIOR CODERS,** Niveli I sipas KKK, lloji: Kualifikimet e Bazuara në Standardet Ndërkombëtare (E) me 11 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit profesional për qendrat: **Prishtinë**: 12 grupe me nga 12 deri në 15 kandidatë për një vit kalendarik. **Prizren**: 5 grupe me nga 10 kandidatë për një vit kalendarik. **Pejë**: 5 grupe me nga 12 kandidatë për një vit kalendarik. **Mitrovicë**: 5 grupe me nga 12 kandidatë për një vit kalendarik. **Gjilan**: 5 grupe me nga 12 kandidatë për një vit kalendarik.
   - **1.2. JUNIOR FULL STACK DEVELOPER,** Niveli II sipas KKK, lloji: Kualifikimet e Bazuara në Standardet Ndërkombëtare (E) me 11 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit profesional për qendrat: **Prishtinë**: 11 grupe me nga 12 deri në 15 kandidatë për një vit kalendarik. **Prizren**: 5 grupe me nga 10 kandidatë për një vit kalendarik. **Pejë**: 5 grupe me nga 10 kandidatë për një vit kalendarik. **Mitrovicë**: 5 grupe me nga 8 kandidatë për një vit kalendarik. **Gjilan**: 5 grupe me nga 8 kandidatë për një vit kalendarik.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit "JCODERS" SH.P.K, për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucioni "JCODERS" SH.P.K, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK